



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. 236/1 prot.

Tiranë, më 19.6.2024

**Lënda:** Parashtrime të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 25.6.2024, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 657, datë 28.4.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Periand Teta.

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese

*Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,*

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 28.4.2023, është njoftuar vendimi nr. 657, datë 28.4.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (*në vijim Komisioni*), për subjektin e rivlerësimit, z. Periand Teta, Ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë.

Komisioni, në vlerësim të situatës ligjore dhe faktike të subjektit të rivlerësimit, ka vendosur: “*Të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar për z. Periand Teta*”.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, brenda afatit ligjor 15-ditor, nga njoftimi i vendimit, ka ushtruar të drejtën e ankimit.

Duke u qëndruar të gjitha shkaqeve të parashtruara në ankimin e datës 12.5.2023, kundër vendimit nr. 657/2023, të Komisionit, Komisioneri Publik, në konsideratë të qëllimit të përcaktuar nga neni 179/b i Kushtetutës, jurisprudencës tashmë të konsoliduar të Kolegjit për rastet e ndërprerjes/përfundimit të procesit të rivlerësimit, për rastin konkret, çmon se vendimi

i Komisionit<sup>1</sup> nuk është i drejtë dhe i bazuar në situatën faktike të dokumentuar nga aktet në fashikull, për sa, në mënyrë të përmbledhur, trajton në vijim:

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta, ka ushtruar funksionin e Ndhmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, prej datës \*\*.2.2014 deri në datën \*\*.7.2017<sup>2</sup>, duke u klasifikuar si subjekt rivlerësimi *ex officio*, bazuar në parashikimet e nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe nenin 165/2 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

1.1 Në vijim, vetë subjekti i rivlerësimit, z. Teta, e ka konsideruar veten si të tillë, përsa kohë që në janar të vitit 2017, ka plotësuar dhe dorëzuar deklaratën e pasurisë në ILDKPKI, bazuar në nenin 31 të ligjit nr. 84/2016, deklaratën për kontrollin e figurës, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, bazuar në nenin 35 të ligjit nr. 84/2016 dhe formularin e vetëvlerësimit profesional pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në nenin 41 të ligjit nr. 84/2016.

1.2 Në analizë të kuadrit kushtetues, ligjor dhe në vlerësim të rrethanave faktike që i përkasin subjektit të rivlerësimit, konstatohet se në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë<sup>3</sup>, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, z. Teta ushtronte funksionin e Ndhmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë. Ndhmësit ligjorë të Gjykatës së Lartë kategorizohen në rrethin e subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, edhe nga ligji nr. 84/2016, në vijim të parashikimeve të nenit 3, pika 16<sup>4</sup> e tij.

1.3 Komisioneri Publik, në raport me kuadrin ligjor të zbatueshëm, dhe jurisprudencën e Kolegjit<sup>5</sup>, konstaton se Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 parashikojnë, në mënyrë të shprehur dhe shteruese, subjektet që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit dhe ecurinë e procesit,

---

<sup>1</sup> Komisioni, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] 19. Në analizë të fakteve, provave dhe kuadrit ligjor, z. Periand Teta ka dhënë pëlqimin në mënyrë të heshtur për ndërprerjen e kontratës së tij të punës lidhur me ushtrimin e detyrës së ndihmësit ligjor, duke mos e ankmuar atë në gjykatë. Shprehja e vullnetit në këtë rast nëpërmjet mungesës së kundërshtimit në rrugë gjyqësore konsiderohet nga trupi gjykues se është shprehje e pëlqimit të heshtur dhe dakordësim i tij lidhur me këtë procedurë. 20. Pavarësisht të drejtës ligjore të përmendur nga vetë z. Periand Teta në shkresën nr. \*\*\*/ prot., datë \*\*.7.2017, drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Lartë, ai nuk ndërmori asnjë hap ligjor lidhur me sa referonte te kërkesa e tij mbi veprimet, të cilat cenonin të drejtat e punëmarrësit, veprimet e punëdhënësit dhe respektimin e të drejtave dhe detyrimeve gjatë marrëdhënies së punës. 23. Komisioni ka vlerësuar se z. Periand Teta nuk ishte subjekt rivlerësimi i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për sa kohë në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ai nuk e ushtronte efektivisht detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë. 29. Komisioni, pasi ka kërkuar informacion pranë Gjykatës së Lartë lidhur me pagesat e marra nga ndihmësi ligjor dhe me shkresën nr. \*\*\*/\* prot., datë \*\*.3.2023, të Gjykatës së Lartë, është informuar se z. Periand Teta ka përfituar të ardhurat nga paga neto si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë për periudhën \*\*.2.2014 – \*\*.7.2016 dhe nga gushti i vitit 2016 nuk ka përfituar më të ardhura nga paga si ndihmës ligjor. 30. Sa më sipër, Komisioni çmoi se z. Periand Teta nuk gëzonte as statusin e ish- këshilltarit ligjor, për sa kohë nuk provohej se kishte punuar në këtë pozicion për 3 vjet, (sipas dokumentacionit ligjor periudha efektive e punësimit rezultonte nga data \*\*.2.2014 deri më \*\*.7.2016). 31. Në këto kushte, trupi gjykues arriti në përfundimin se z. Periand Teta nuk bën pjesë as në kategorinë e subjekteve të rivlerësimit *ex officio* dhe as nuk mund të trajtohet si ish-këshilltar ligjor duke arritur në konkluzionin se ai nuk ishte objekt i veprimit të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë. [...].

<sup>2</sup> Kur është liruar nga detyra me anë të Urdhërit nr. \*\*\*, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

<sup>3</sup> Të gjithë Këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, Ndhmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, Ndhmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*. Procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet.

<sup>4</sup> 1. “Subjekt i rivlerësimit” janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës. [...] dhe 42, pika 2 “[...] Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, Ndhmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe Ndhmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës”.

<sup>5</sup> Referohuni vendimit (JR) nr. 39/2020, prg.16.

pavarësisht dinamikës së rrethanave që ndikojnë në pozicionin për shkak të të cilit individët kanë fituar statusin e subjektit të rivlerësimit.

1.4 Komisioneri Publik, sikundër Kolegji ka arsyetuar në jurisprudencën e tij, vlerëson se jo domosdoshmërisht subjektet e rivlerësimit, në momentin kur fillonte procedura e rivlerësimit, duhet të mbanin të njëjtën detyrë funksionale për të cilën *ex officio*, Kushtetuta dhe ligji i kanë parashikuar si subjekte rivlerësimi. Nga aktet e administruara, konstatohet qartazi se, në momentin kur u miratuan dhe hynë në fuqi ndryshimet kushtetuese, korrik dhe gusht 2016, që parashikonin kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar, z. Periand Teta ushtronte funksionin e Ndhmësit ligjor, duke qenë subjekt i rivlerësimit dhe, si i tillë, duhet t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit.

1.5 Në praktikën tashmë të konsoliduar lidhur me këtë moment, Kolegji, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *Në kushtet kur ndryshimet kushtetuese që normuan rivlerësimin e gjetën subjektin e rivlerësimit në një nga detyrat e përmendura nominalisht nga pika 3 e kësaj dispozite, ajo ishte subjekt rivlerësimi ex officio. Ky fakt qëndron, është i pakontestueshëm dhe autonom nga momenti kur statusi i magjistratit deklarohet i mbaruar nga institucionet përkatëse...nëse, nga procesi i rivlerësimit do të përjashtoheshin me sukses të gjithë subjektet që nuk ishin në detyrë në momentin kur u vinte radha të shortoheshin apo çështja e tyre të shqyrtohej nga Komisioni, gjatë gjithë harkut kohor prej 5 vjetësh, që përbën mandatin e këtij të fundit, megjithëse e gëzonin këtë cilësi me hyrjen në fuqi të ligjit, procesi i rivlerësimit do të përfshinte subjektet mbi baza tejet rastësore, të kushtëzuara thjesht nga shorti i Komisionit dhe përfundimi ose jo i rivlerësimit deri në momentin në kohë kur, për një arsye të caktuar, nuk kryenin më detyrën që i kishte cilësuar si subjekte rivlerësimi*<sup>6</sup> [...].

1.6 Pas largimit nga detyra në Gjykatën e Lartë, subjekti<sup>7</sup>, z. Teta, në datë \*\*.9.2017<sup>8</sup>, është emëruar Inspektor pranë Drejtorisë së Inspektimit Gjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë dhe njëkohësisht rezultonte të ishte subjekt i procesit të rivlerësimit kalimtar, dhe në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, Komisioni organizoi shortin për caktimin e trupit gjykues në datën **15.6.2021**.

1.7 Komisioneri Publik, nga aktet në fashikull, konstaton se vetë Komisioni e ka konsideruar z. Periand Teta subjekt rivlerësimi dhe ka vazhduar procedurën e rivlerësimit, së paku deri kur me e-mailin e datës **21.6.2021**, ka dërguar pyetësin standart, me 12 pyetje, kryesisht në drejtim të vlerësimit të pasurisë<sup>9</sup>, procedurë e cila ka zgjatur deri më datë **19.4.2023**, kur Komisioni i ka dërguar subjektit rezultatet e hetimit, duke konkluduar me përfundimin e procesit të rivlerësimit pa vendim përfundimtar.

1.8 Nga shqyrtimi i akteve në fashikull, Komisioneri Publik vlerëson se që prej momentit të parë lidhur me statusin e subjektit, më datë **21.6.2021** kur Komisioni, ka vendosur për vazhdimin e procesit të rivlerësimit për z. Periand Teta, si dhe i ka dërguar pyetësin standart, me e-mailin e datës 21.6.2021, duke e vlerësuar si një subjekt të ligjit nr.

<sup>6</sup> Referohuni vendimit (JR) nr. 5/2021, prg. 36.3.

<sup>7</sup> Shih : <https://ild.al/sq/zyra-e-inspektorit-te-larte-te-drejtësisë/stafi-yne/periand-teta/>

<sup>8</sup> Referohuni fq. 8 të Apelit kundërshtues datë 19.5.2023, të depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

<sup>9</sup> Duke i kërkuar subjektit të rivlerësimit t'u kthejë përgjigje këtyre pyetjeve brenda 15 ditëve nga data e dërgimit të këtij email. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, me proces-verbalin e datës 2.7.2021, ia ka kthyer Komisionit, të plotësuar pyetësin standart dhe dokumentacionin bashkëlidhur tij.

84/2016, e në vijim, nuk ka ndryshuar ndonjë rrethanë, që të ndryshonte cilësinë e z. Teta si subjekt rivlerësimi, në mënyrë të tillë, që në rezultatet e hetimit të datës **19.4.2023**, trupi gjykues i Komisionit të dilte në një përfundim të ndryshëm, duke konstatuar se z. Periand Teta nuk e gëzonte më statusin e subjektit të rivlerësimit.

1.9 Komisioni, në raport me ecurinë e mëtejshme të procesit të rivlerësimit, në rastin konkret nuk ka identifikuar drejtë shkaku ligjor determinant për përfundimin e procesit të rivlerësimit për subjektin, pa një vendim përfundimtar. Nisur nga arsyetimi i vendimit për cilësimin e statusit ligjor të subjektit, Komisioni fillimisht ka arsyetuar nën regjimin e nenit 179/b, pika 4, fjalia e parë, *këshilltarët ligjorë* të Gjykatës së Lartë, dhe në vijim për një kategori tjetër, atë *ish-këshilltarit*, status i cili gjen një rregullim tërësisht të ndryshëm ligjor, referuar rregulimeve të përcaktuara në dispozitat e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht nenet 31, pika 3, 35, pika 3 dhe 41, pika 2, të këtij ligji, pra respektimit të rrugës procedurale dhe afatit 3 mujor nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

1.10 Komisioneri Publik e vlerëson jo të bazuar arsyetimin e Komisionit se z. Teta nuk gëzonte statusin e subjektit të rivlerësimit, pasi në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ai ishte i pezulluar nga funksioni i ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, dhe nuk e ushtronte efektivisht detyrën, dhe as paguhej për këtë detyrë. Në këtë vlerësim, duket se Komisioni merr atributet e një juridiksioni tjetër, duke arsyetuar mbi elementet kontraktuale dhe efekteve ligjore të tyre në marrëdhënien e punës, duke barazuar periudhën e punësimit të subjektit pranë Gjykatës së Lartë (\*\*.2.2014 deri në \*\*.7.2017), me periudhën që ka përfutuar të ardhura financiare nga detyra (\*\*.2.2014 deri në \*\*.7.2016). Në vlerësimin e Komisionerit Publik, këto dy momente nuk kanë asnjë arsye ligjore për t'u barazuar, pasi rëndësi ka vetëm statusi ligjor që gjendet subjekti në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, si dhe vullneti apo qëndrimi i subjektit në raport me ecurinë e procesit të rivlerësimit, si dhe vlerësimi i ekzistencës së kushteve ligjore për ndërprerjen e këtij procesi pa një vendim përfundimtar. Në këtë kontekst, fakti i pezullimit nga detyra nuk është një rrethanë relevante dhe e aftë të ndikojë në vijimin apo jo të procesit të rivlerësimit, për sa kohë që ajo është një rrethanë e ndryshueshme, e papërcaktuar në mënyrë përfundimtare dhe me efekte jo shuese për të drejtat dhe statusin e subjektit.

1.11 Në rastin konkret, në vlerësimin e Komisionerit Publik, merr rëndësi fakti që subjekti, në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, ligjërisht ushtronte funksionin e ndihmësit ligjor në organikën e Gjykatës së Lartë, duke plotësuar në këtë mënyrë përcaktimin e pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

1.12 Në përfundim të kësaj analize, mbi kuadrin ligjor të zbatueshëm, jurisprudencën e Kolegjit dhe aktet në dosje, Komisioneri Publik vlerëson se z. Periand Teta e ka fituar *statusin ligjor të subjektit të rivlerësimit*, që në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve Kushtetuese<sup>10</sup>, e për pasojë, do të duhej t'i nënshtruhej *ex officio* procesit të rivlerësimit kalimtar, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, i cili rregullon këtë proces.

---

<sup>10</sup> Detyra funksionale e subjektit të rivlerësimit, z. Teta, mbaroi në muajin korrik 2017, pra rreth 11 muaj pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese (11.8.2016), rreth 7 muaj pas fillimit të zbatimit të ligjit nr. 84/2016 (19.1.2017)

2. Komisioneri Publik vlerëson se arsyetimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta [...] nuk ishte subjekt rivlerësimi (ex officio) i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për sa kohë në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ai nuk e ushtronte efektivisht detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë... Nuk gëzonte as statusin e ish- këshilltarit ligjor, për sa kohë nuk provohej se kishte punuar në këtë pozicion për 3 vjet, sipas dokumentacionit ligjor periudha efektive e punësimit rezultonte nga data \*\*.2.2014 deri më \*\*.7.2016.... Në këto kushte trupi gjykues arrin në konkluzionin se ai nuk ishte objekt i veprimit të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë. Dhe se në rastin konkret jemi para zbatimit të nenit 95, të K. Pr. Administrative, dhe organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur [...], nuk është i drejtë dhe nuk gjendet në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit.

2.1 Bazuar në rrethanat e çështjes, zbatimi i normës së përgjithshme, sipas parashikimit të nenit 95 të Kodit të Procedurës Administrative, ndërkohë që ekziston parashikimi i posaçëm sipas nenit G, të aneksit të Kushtetutës dhe rregullimeve të ligjit nr. 84/2016, e bën të gabuar qëndrimin e mbajtur nga Komisioni, për sa i përket identifikimit të ligjit të zbatueshëm në rrethanat faktike konkrete.

2.2 Komisioneri Publik, në kuadër të analizës mbi përmbushjen e kriterëve për zbatimin e nenit G të aneksit të Kushtetutës, si dhe referuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, konstaton si vijon :

2.3 Komisioni ka kërkuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor informacion mbi shprehjen e vullnetit të subjektit për dorëheqje nga funksioni i ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë. Nga aktet e përcjella nga KLGj, me shkresën nr. \*\*\*/\* prot., datë \*\*.3.2023, nuk konfirmohet një kërkesë formale me shkrim për dorëheqje nga funksioni i ndihmësit ligjor, por një shkresë e subjektit, datë \*\*.7.2017, drejtuar punëdhënësit mbi vijueshmërinë e marrëdhënieve të tij të punës. Në vijim të saj ka dalë urdhëri i Kryetarit të Gjykatës së Lartë nr.\*\*\* në datë \*\*.7.2017, për përfundimin e kontratës së punës të z. Periand Teta dhe lirimimin e tij nga detyra, në këtë datë, pa efekte të mëparshme.

2.4 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa pretendon subjekti<sup>11</sup>, vlerëson se Urdhri nr.\*\*\*, datë \*\*.7.2017, i Kryetarit të Gjykatës së Lartë për lirimimin e subjektit nga detyra, për shkak të ndryshimeve ligjore<sup>12</sup>, nuk përbën arsye për përfundimin e marrëdhënies së punës së subjektit të rivlerësimit, “ për arsye ligjore ”, sipas nenit 165 paragrafi i 2 i ligjit nr.96/2016. Akti për lirimimin e subjektit nga detyra është nxjerrë në mungesë të kompetencës së Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë, dhe për pasojë subjekti i rivlerësimit nuk e ka humbur statusin e ndihmësit ligjor dhe ndërprerë marrëdhënien e punës për shkak të këtij urdhri. Nga ana tjetër, pas largimit nga detyra në Gjykatën e Lartë, rezulton se subjekti<sup>13</sup>, z. Teta, në datë \*\*.9.2017 është emëruar me

<sup>11</sup> Referohuni Apelit kundërshtues datë 19.5.2023, (fq. 5 paragrafi i dytë) të depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

<sup>12</sup> Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2006 (n.179/b e Kushtetutës); ligji nr.96/2016 (neni 165 pika 1 dhe 2); ligji nr. 96/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë (neni 34 pika 5 dhe neni 84 pika 4).

<sup>13</sup> Si nga burimet e hapura të aksesueshme lehtësisht prej tij, që kanë statusin e fakteve të njohura botërisht, sipas përcaktimit të nenit 13 të Kodit të Procedurës Civile, Shih : <https://ild.al/sq/zyra-e-inspektorit-te-larte-te-drejtësisë/stafi-yne/periand-teta/ashtu-edhe-përsa-ka-pohuar-vet-subjekti-në-apelin-kundërshtues>.

pëlqimin e tij në pozicionin e ri të Inspektorit pranë Drejtorisë së Inspektimit Gjyqësor, në Ministrinë e Drejtësisë.

2.5 Komisioneri Publik, ashtu sikurse Kolegji ka arsyetuar në jurisprudencën e tij<sup>14</sup>, çmon se vlerësimi i urdhrit të kryetarit të Gjykatës së Lartë lidhur me marrëdhënien e punësimit të subjektit të rivlerësimit, z. Periand Teta, si Ndhmës ligjor, është paralel dhe, për pasojë, pa asnjë peshë mbi faktin që subjekti i rivlerësimit e kishte fituar këtë cilësi në mënyrë të shprehur në parashikimin e nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, ashtu sikurse arsyetuar dhe më lart.

2.6 Sa më sipër, Komisioneri Publik, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se Komisioni kishte kompetencën për të konstatuar se efektet e urdhrit nr. \*\*\*, në datë \*\*.7.2017, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, nuk ndikonin në ecurinë e procesit të rivlerësimit të subjektit, z. Periand Teta, në kushtet kur: (i) *subjekti kishte statusin e padiskutueshëm të subjektit të rivlerësimit*; (ii) *Kushtetuta dhe ligji ia kishin njohur vazhdimësinë në detyrë të Ndhmësave/Këshilltarëve ligjorë, duke rregulluar procedurat dhe përcaktuar organet përgjegjëse për karrierën e tyre, të ndryshëm nga Kryetari i Gjykatës së Lartë*.

2.7 Në këto rrethana ligjore dhe faktike, konstatohet se vendimi i Komisionit nuk gjen mbështetje në qëllimin e legjislatorit që Ndhmësit ligjorë të Gjykatës së Lartë t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit. Legjislacioni që normon procesin e rivlerësimit parashikon qartësisht se institucionet e rivlerësimit duhet të rivlerësojnë subjektet e përcaktuara shprehimisht në nenin 179/b, të Kushtetutës. Në rast se këto subjekte vendosin të mos i nënshtrohen këtij procesi, atëherë ata përjashtohen nga mundësia e emërimit në disa prej organeve të drejtësisë, për një periudhë 15-vjeçare, sipas përcaktimeve në pikën 2, të nenit G, të aneksit të Kushtetutës.

2.8 Në analizë të rrethanave faktike, të trajtura gjerësisht dhe në ankimin e datës 12.5.2023, Komisioneri Publik, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se nuk ushtronte detyrën e Ndhmësit ligjor, në momentin e zhvillimit të procesit në Komision, vazhdonte të ruante statusin e subjektit të rivlerësimit dhe në këto kushte, procesi i rivlerësimit ndaj tij mundej të përfundohej me rivlerësimin e tri kritereve apo për shkak të vullnetit të tij ose të ndërpritej me pasojën ligjore të parashikuar nga neni G i aneksit të Kushtetutës. Në këtë kuadër, Komisionit, ashtu sikurse Kolegji ka vepruar në jurisprudencën e tij, i mbetej dhe duhej të *verifikonte vullnetin e tij për të mos iu shmangur dhe përfunduar procesin e rivlerësimit*.

2.9 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, në kontekstin edhe të orientimit të dhënë nga ana e Kolegjit për verifikimin e vullnetit për dorëheqjen e subjekteve të rivlerësimit, vlerëson se *mungesa e një akti formal të shprehjes së vullnetit për dorëheqje nga detyra, nuk mund ta përjashtojnë subjektin e rivlerësimit nga përcaktimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës*<sup>15</sup>.

2.10 Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit e ka shprehur vullnetin e tij për dorëheqje nga detyra e Ndhmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, në kushtet kur, me veprime dhe mosveprime të tij, nuk kundërshtoi ligjërisht urdhërin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë për lirim nga detyra, ndërsa ka shfaqur vullnetin duke pranuar detyrën e Inspektorit pranë Drejtorisë së Inspektimit Gjyqësor, në Ministrinë e Drejtësisë.

---

<sup>14</sup> Referohuni vendimit (JR) nr. 39/2020, paragrafi 27.

<sup>15</sup> Referohuni vendimit (JR) nr.35, datë 27.7.2023, prgr.32; vendimit (JR) nr.23, datë 21.5.2024.

2.11 Në këto rrethana faktike, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>16</sup>, një sjellje e tillë e subjektit duhej vlerësuar nga Komisioni si shkak për përfundimin e marrëdhënies së tij të punës si Ndhmës ligjor në Gjykatën e Lartë, dhe si e tillë, përmbush kushtet për t'u kualifikuar si dorëheqje nga detyra, për sa kohë rikthimi në detyrën që mbante, nëpërmjet ankimimit ishte një mundësi ligjore, e përjashtuar me vullnetin e tij të lirë.

2.12 Në çfarëdo konteksti ligjor apo faktik, vendimi i Komisionit, nuk gjen mbështetje në qëllimin e legjislatorit që Ndhmësit ligjorë, t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit. Legjislacioni që normon procesin e rivlerësimit parashikon qartësisht se institucionet e rivlerësimit duhet të rivlerësojnë subjektet e përcaktuara shprehimisht në pikën 4 të nenit 179/b të Kushtetutës. Në rast se, këto subjekte vendosin të mos i nënshtrohen këtij procesi, atëherë ata përjashtohen nga mundësia e emërimit në disa prej organeve të drejtësisë, për një periudhë 15-vjeçare, sipas përcaktimeve në pikën 2 të nenit G të aneksit të Kushtetutës.

2.13 Kolegji në jurisprudencën e tij është shprehur se parashikimi i nenit G të aneksit të Kushtetutës është shterues. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit shoqërohet pashmangshmërisht me ndalimin ligjor për t'u emëruar në pozicione specifike për 15 vjet. Kjo dispozitë zbatohet për të gjitha kategoritë e funksionarëve të sistemit të drejtësisë që, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, kanë fituar statusin *subjekt rivlerësimi*, pa bërë dallime ndërmjet tyre, qoftë edhe për shkak të kohëzgjatjes së kufizuar të ushtrimit të detyrës. Në raport me procesin e rivlerësimit, të gjitha këto subjekte konsiderohen të barabarta.

**3.** Në përfundim, Komisioneri Publik, bazuar në të gjitha rrethanat e paraqitura në ankimin e datës 12.5.2023, vlerëson se vazhdimi i procesit të rivlerësimit për subjektin z. Periand Teta, ishte parakusht i padiskutueshëm dhe, në kuptim të parashikimeve kushtetuese, lidhur me procesin e rivlerësimit, duke qenë se qëllimi i procesit është rivlerësimi kalimtar i të gjithë subjekteve të rivlerësimit, për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisht së sistemit të drejtësisë dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, dhe ndërpreja e procesit të rivlerësimit, duhet të shoqërohet me pasojat ligjore të nenit G të aneksit të Kushtetutës.

3.1 Komisioneri Publik nënvizon se çdo interpretim i kundërt që do të bënte të mundur, sikundër ka lejuar Komisioni në rastin konkret, ushtrimin e njërit prej funksioneve të parashikuara nga neni G i aneksit të Kushtetutës, si të ndaluara për t'u ushtruar për 15 vjet, nga një individ, që për shkak të Kushtetutës është subjekt i procesit të rivlerësimit, e që kërkon t'i shmanget këtij procesi, duke kërkuar ndërprerjen e tij, vjen në kundërshtim me qëllimin e sanksionuar në paragrafin e parë të nenit 179/b të Kushtetutës dhe me jurisprudencën e Kolegjit.

3.2 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në analizë të rrethanave të faktit dhe kuadrit ligjor të zbatueshëm, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar të drejtat e tij, duke bërë një zgjedhje personale, duke shprehur vullnetin e pavesur për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, duke zgjedhur të ketë dhe ndalimin ligjor që parashikon neni G i aneksit të Kushtetutës.

### **Kërkimi i ankimit**

**4.** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj

---

<sup>16</sup> Referohuni vendimit (JR) nr.35/2023, të Kolegjit, prgr.32; vendimit (JR) nr.23, datë 21.5.2024.

vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, dhe çmim të drejtë të provave të administruara;

5. Në përfundim të shkaqeve të ankimit, pas verifikimit të situatës faktike nëpërmjet akteve të administruara gjatë procesit të hetimit nga Komisioni, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm dhe jurisprudencës së Kolegjit, Komisioneri Publik vlerëson se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 657, datë 28.4.2023, për deklarimin e përfunduar të procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar, për subjektin e rivlerësimit, z. Periand Teta, nuk është marrë në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore;

6. Referuar nenit 179/b të Kushtetutës, nenit F, të aneksit të Kushtetutës, jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66/1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 657, datë 28.4.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në këtë mënyrë:

1. *Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit ndaj subjektit, z. Periand Teta.*

2. *Ndalimin e subjektit të rivlerësimit, z. Periand Teta, të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshme për një periudhë 15-vjeçare.*

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Irena NINO**